



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta -Ministry of Culture, Youth & Sports

Departamenti i Trashëgimise Kulurore

Sfond për projektin:

Vazhdimi i Projektit Kapital "Kalaja e Prizrenit" për vitin 2021, projekt me karakter "Konservim/ Restaurim, Menaxhim dhe promovim të lokalitetit, " zbatohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës. Projekti synim primar ka vazhdimin e konservimit dhe menaxhimin e lokalitetit, si dhe procesimin- botimin e rezultateve shkencore arkeologjike- Katalogut. Sezoni i punes në Kalanë e Prizrenit është planifikuar të filloj në javën e katërt të muajit shtator, menjëherë pas përgatitjeve që janë bërë si punë kabinetike, projektim dhe pastrimi paraprak i tërë hapësirës së kalasë. Projekti është paraparë të zgjas 2 muaj kalendarik me gjithsej maksimumi 50 ditë pune. Udhëheqës i projektit: Dr. Shafi Gashi.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Shpall:

KONKURS

Për rekrutimin e punonjësëve teknik për zbatimin e projektit "Vazhdim i Projektit Kapital Kalaja e Prizrenit" 2021, i cili ka për fokus menaxhimin, konservimein, promovimin si dhe rregullime të infrastëkturës së kalas se Prizrenit, me qëllim të promovimit arkeo- turistik.

- Arkeolog për përgaditjea e katalogut arkeologjik- tre (3);
- Staf profesional (arkeolog ose historian) për menaxhim dhe promovim të Kalasë së Prizrenit- kater (4);
- Restaurator- Konservator - dy (2);
- Fotograf & Arkitekt- Dizajner- nje (1);
- Skicograf - një (1);
- Punëtor fizik- dymbëdhjetë (12);



I.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Arkeolog për përgaditjen e katalogut arkeologjik

Numri i personave që do të rekrutohen: 3

Ditë angazhimi: 50

Kategoria funksionale /Koefficienti:

Një ditë = 23.00 Euro

Numri i referencës: 01-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizrenit- Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha udhëzimet e Arkeologut- Udhëheqësit të Projektit.
2. Të zbatojnë procedurat standarde të teknikave, praktikave dhe metodave arkeologjike dhe dokumentimit teknik si dhe të jenë të përgjegjshëm gjatë punimeve duke udhëzuar, mbikqyrur, përcjellë, punuar ngushtë dhe duke i raportuar verbalisht dhe/ose me shkrim Arkeologut përgjegjës.
3. Të ndjekin me përpikëri dhe në mënyrë sistematike dokumentimin e detajuar të gjetjeve (në formularët përkatës), të kontekstit të gjetjës me nivel matës, plotësimin e të dhënave, dokumentimin dhe procesimin e fragmenteve të artefakteve, ekofakteve, materialit osteologjik duke i sistemuar dhe etiketuar si dhe të kryejnë dokumentimin teknik të strukturave apo tipareve arkeologjike të zbuluara in situ. Po ashtu duhet të angazhohen në sistemimin e gjetjeve arkeologjike sipas rëndësisë, vlerës arkeologjike apo dhe të materialit kuantitativ.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohës me përvojë të dokumentimit arkeologjik, me shkollim apo eksperiencë nga fusha e arkeologjisë apo disiplinave relevante
2. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës
3. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

II.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Staf profesional(arkeolog- historian ose fushe e përafert e trashëgimis kulturore) për menaxhim dhe promovim të Kalasë së Prizrenit.

Numri i personave që do të rekrutohen: 4

Ditë angazhimi: 6 muaj (144 dite pune)

Kategoria funksionale /Koefficienti:

Një ditë = 23.00 Euro

Numri i referencës: 02-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizrenit- Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha udhëzimet e Arkeologut Udhëheqës/Përgjegjësit të Kalase
2. Të ketë njohuri të mira në fushën e trashëgimis kulturore, e sidomos nga zona e Prizrenit, kalas dhe muzeut të kalas
3. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe promovimi të trashëgimis kulturore
4. Të ketë njohuri dhe përvoj pune në kalan të Prizrenit.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës
2. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

III.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sport/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Skicograf

Numri i personave që do të rekrutohen: 1

Ditë angazhimi: 45

Kategoria funksionale /Koefficienti:

Një ditë = 23.00 Euro

Numri i referencës: 03-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizrenit- Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjek të gjitha udhëzimet e Arkeologut Udhëheqës
2. Vizatimi, skicimi i materialeve arkeologjike paraqitjen grafike të gjetjeve të paraqitur me shkallë zvogëluese përmes vizatimeve teknike skicuar me dorë dhe përpunuar në formë digjitale
3. Skicimin me dorë dhe në mënyre digjitale të objekteve të gjetura dhe planimetrive
4. Kryen dokumentimin teknik përmes vizatimit teknik dhe në formë të digjitalizuar.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

5. Profesionist, të diplomuar apo dhe student të fushave përkatëse e të afërta me Arkeologjinë (Arkeologji, Arkitekturë a Art) me njohuri për vizatimin e planimetrive dhe materialit të luajtshëm arkeologjik
6. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës, veçanërisht përvojës në skicim
7. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

IV.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sport/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Punëtor fizik.

Numri i personave që do të rekrutohen: 12

Ditë angazhimi: 40

Kategoria funksionale /Koeficienti:

Një ditë = 20.00 Euro

Numri i referencës: 04-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizreni - Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha udhëzimet e Arkeologut Udhëheqësit- Përgjegjësit
2. Asistojnë në punë sipas udhëzimeve të Arkeologut- Udhëheqësit të projektit
3. Të jenë në gjendje të mirë shëndetsore që të kryejnë punë fizike me kazmë, lopatë, karrocë, mistri dhe mjete tjera pune
4. Të bashkëpunojnë ngushtë me udhëheqësin e grupit.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Punëtor krahu me njohuri bazë mbi proceset e punëve konservuese/ restauruese
2. Të dorëzohet një CV me detaje të përvojës
3. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

V.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Restaurator- Konservator

Numri i personave që do të rekrutohen: 2

Ditë angazhimi: 45

Kategoria funksionale /Koefficienti:

Një ditë = 23.00 Euro

Numri i referencës: 05-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizrenit- Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha udhëzimet e Arkeologut-Udhëheqësit
2. Analizojnë përmbajtjen fizike/kimike të materialeve të strukturave dhe objekteve të (luajtshme dhe të paluajtshme) arkeologjike dhe jep rekomandime për teknikat e konservimit/konsolidimit
3. Zbaton punët mirëmbajtëse dhe konservuese/konsoliduese në lokalitet.
4. Njohës me përvojë i konservimit të strukturave arkeologjike.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

5. Ekspert i konservimit nga fusha të afërta me Arkeologjinë (Konservim-Restaurim/Arkeologji, Konservim-Restaurim/ Arkitekturë, etj)
6. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës, veçanërisht përvojës në konservim.
7. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

VI.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/ Instituti Arkeologjik i Kosovës

Titulli i punës: Fotograf & Arkitekt- Dizajner

Numri i personave që do të rekrutohen: 1

Ditë angazhimi: 45

Kategoria funksionale /Koefficienti:

Një ditë = 23.00 Euro

Numri i referencës: 06-09/2021

Vendi: Kalaja e Prizrenit- Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha udhëzimet e Arkeologut- Udhëheqësit
2. Të fotografon me aparat profesional fotografik dhe përpunohen fotografit e objekteve për katalog
3. Të përpunon me programe speciale softwer-ike dhe sistemon fotografitë sipas kërkesës së Arkeologut-Udhëheqësit.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

4. Të jetë Fotograf me përvojë pune në fushën e Trashëgimisë Arkeologjike
5. Arkitekti- Dizajneri të ketë përvojë në fushën e trashëgimis kulturore
6. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës, së punës në fushën e Trashëgimisë Kulturore
7. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

Përzgjedhja e kandidateve:

Përzgjedhja e kandidateve do të bëhet nga Komisioni Profesional përmes intervistimit të secilit kandidat që i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë konkurs.

Procedurat e konkurrimit:

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs.

Shënim: Transportimi i kandidatëve të përzgjedhur në Kalanë e Prizrenit mbetet përgjegjësi individuale.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e aplikimit është nga 22.09.2021

Dokumentacioni i kandidatëve aplikant duhet të dërgohet deri me 30.09.2021 në ora 14:00 adresën:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore për Projektin “Vazhdim i Projektit Kapital Kalaja e Prizrenit- Prizren ”